



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVO BAR ASSOCIATION

V. KD. Nr.7-3/2022

**KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga Fitim Shporta - Kryetar, Bajram Lajqi anëtar dhe Adnan Pacolli anëtar, me pjesëmarrjen e Vjollca Ajeti, Administratore në Zyrën Disiplinore në OAK - Procesmbajtëse, duke vendosur lidhur me Propozimin e Prokurorit Disiplinor me Nr.71-7/2020 të datës 16.03.2022, ndaj të paraqiturit \_\_\_\_\_, avokat në \_\_\_\_\_ me adresën, Rruga \_\_\_\_\_, Prishtinë, konform nenit 16, lidhur me nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së të datës 07.03.2020, pas zhvillimit të seancës së shqyrtimit fillestar më datën **13.04.2022**, merr këtë:

#### V E N D I M

- I. **HUDHET** Propozimi i Prokurorit Disiplinor me nr.71-7/2020 të datës 16.03.2022.
- II. Shpenzimet procedurale bien barrë e buxhetit të OAK-së.

#### A r s y e t i m

Kolegji Disiplinor i OAK-së, pas pranimit të Propozimit nga Prokurori Disiplinor i OAK-së, e ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 13.04.2022, në përbërje të plotë.

Kolegji Disiplinor i OAK-së në seancën e mbajtur me shqyrtim fillestar pasi bëri shiqimin dhe analizimin e shkresave të lëndës të bashkangjitura si në Propozimin e Prokurorit Disiplinor me Nr.71-7/2020 të datës 16.03.2022 mori vendim, që Propozimin e lartëcekur ta kthej në plotësim konform nenit 13 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së duke kërkuar nga ZPD që të bëjë plotësimin e Propozimit sa i përket emrit, mbiemrit, adresës dhe numrit të telefonit të ushtruesit të fletëparaqitjes, po ashtu ka kërkuar plotësimin sa i përket përshkrimit të kohës së shkeljes së pretenduar disiplinore.

Meqenëse ZPD me plotësimin e Propozimit Disiplinor me nr.71-9/2020 të datës 07.04.2022 edhe pse ka tentuar të sigurojë informata shtesë si është cekur në plotësimin e Propozimit nuk ka arritur që të bëjë si edhe është cekur në plotësimin e propozimit të cekur, andaj

Komisioni Disiplinor i OAK-së konform nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Shpenzimet procedurale konform nenit 37 paragrafit 2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së bien në barrë të buxhetit të OAK-së.

**Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës**  
**V.KD. Nr.7-3/2022 të dt: 13.04.2022**

**Procesmbajtësja:**  
**Ma.sc.Vjollca Ajeti**



**Kryetar i Kolegjit Disiplinor:**  
**Av. Fitim Shporta**



**KËSHILLË JURIDIKE**

Kundër këtij vendimi, nuk është e lejuar ankesa konform nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së